



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 778/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e Shyqri Segaqi, anëtarë për Kuvendin Komunal në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik AKR, me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i Shyqri Segaqi, anëtarë për Kuvendin Komunal në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik AKR, me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, me shenjën ZL.Anr.778/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.778/2017 me datën 09.11.2017, nga Shyqri Segaqi, anëtarë për Kuvendin Komunal në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik AKR, me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, me të cilën pretendon se ka pasur mospërputhje të votave në FPR-ve të skanuara me ato që i ka vendos KQZ-ja, në këto Vendvotimë: Shipol 1103B-03R-04R-05R-06R-07D, Vërnice 1128B-01D, Vaganice 1105B-01R-03R-04R-05R-06D, Bedri Gjina 1111/B-01R-02R-04D, Ismail Qemali 1104B-01R-02R-03R-04R-07R-08R, Abdullah Shabani 1102x-01R-02R-03R-04R-06R-07R-010R-011R-012R-013R-015R-016D, Melenice 1132B-01D, Bajgorë 1121B-01R-02D, Tuneli i Parë 116D-02R dhe Zhabarë 1101B-01R-03R-04D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit gjeti se ankuesi me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar për të vërtetuar pretendimet e tij. Prandaj Paneli ankesën e ankuesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.778/2017 më datën 11.11.2017.

Kryesuese e Panelit
Rafet Haxhaj



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*